

20191802779

L I G J
PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM
KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15, 30/16, 21/18 dhe 245/18), pas nenit 58 shtohet nen i ri 58-a si vijon:

"Neni 58-a

(1) Anëtari i fondit të detyrueshëm pensional që ka mbushur stazh të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar që mundëson uljen e kufirit të moshës për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit, në pajtim me nenin 118 paragrafi (3) të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, mund të zgjedhë ta vazhdojë anëtarësimin në shtyllën e dytë pensionale me deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësimit në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej tre muajve nga mbushja e stazhit të sigurimit.

(2) Nëse anëtari i fondit të detyrueshëm pensional, gjatë kohëzgjatjes së afatit nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk jep deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësimit në fondin e detyrueshëm pensional, pas kalimit të këtij afati i ndërpritet anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional.

(3) Pas ndërprerjes së anëtarësimit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, shoqëria e bartë shumën totale të mjeteve nga llogaria individuale e anëtarit në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia. Pas bartjes së kryer të mjeteve, shoqëria e mbyll llogarinë individuale të anëtarit."

Neni 2

(1) Anëtari i fondit të detyrueshëm pensional i cili deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka mbushur stazh të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar që mundëson uljen e kufirit të moshës për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit, në pajtim me nenin 118 paragrafi (3) të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, mund të zgjedhë ta vazhdojë anëtarësimin në shtyllën e dytë pensionale me deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësimit në fondin e detyrueshëm pensional, më së voni deri me 30 nëntor 2019.

(2) Nëse anëtari i fondit të detyrueshëm pensional, gjatë kohëzgjatjes së afatit nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk jep deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësimit në fondin e detyrueshëm pensional, pas kalimit të këtij afati i ndërpritet anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional.

(3) Pas ndërprerjes së anëtarësimit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, shoqëria e bartë shumën totale të mjeteve nga llogaria individuale e anëtarit në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia. Pas bartjes së kryer të mjeteve, shoqëria e mbyll llogarinë individuale të anëtarit.

Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".